

LETRAT E LEXUESVE:

Z. Shefki!

Së pari Ju uroj Vitin e Ri 1997, Juve, si dhe bashkëpunëtorëve e lexuesve të DRITËS! Ju falenderoj për punën që po bëni! Ne, për sa i përket shtypit-në Suedi, jemi pak të informuar rreth asaj që po ndodhë në Kosovë e më gjerë. Unë e pres me padurim DRITËN, e cila po na del për çdo muaj. Kjo gazetë është mjaft e thukët e aktuale.

Mbi të gjitha e pacenzurë!

I lexoj me ëndje të gjitha intervistat, e posaçërisht ato të ish burgosurve politikë sepse aty e mësojmë një histori që, për fat të keq, është e pashkruar ende.

E di se Ti je luftëtar i 3% dhe përkrahja që ti i jep këtij akcioni në gazetë është për çdo lavdatë!

Unë mendoj se përcarjet në kreun tonë politik po shkaktojnë huti e po ndikojnë edhe në rënjen e këtij obligimi qeveritar të cilën e kemi borxh, të gjithë, papërshtim.

Juaji: Sinan Bardoniqi
Föreningsgatan 65
261 34 Landskrona
0418-23 2 57

Z. Shefki!

Unë po t'i dërgoj pak të holla për do numra të gazetës suaj, të cilën Ju rregullisht ma keni dërguar. Të lutem më trego se sa kam borxh, sepse si thot fjala popullore, pakica të koritë.

Në anën tjetër gazetës për t'u botuar i duhen paratë.

Gazeta e juaj DRITA po del çdo ditë e më e pasur. Ju dëshiroj suksese edhe në të ardhmen si Juve, poashtu edhe familjes suaj, duke iu uruar Ditën e Pavarësisë si dhe Vitin e Ri 1997!

Përsëndetje nga:
Fejzë Halili
Vetekornsgat. 27
431 46 Mölndal

Lajmërim!

I njohtojmë lexuesit se së shpejti do të shpallim konkurs të ri letrar, meqë në konkursin tonë të parë nuk pat konkurrencë të mjaftueshme nga kandidatët.

z. Oseku!

Pranoni përsëndetjet e mia të përzemërta dhe suksese në punë!

PS. Ju lutem ma botoni demantin tim!

Juaji: Shefki Mehmeti, Finlandë

En god jul och ett gott nytt år tillönskas dig och alla läsare av tidskriften "Drita" av den ständige medarbetaren

Ullmar Qvick

Urime për Krishtlindjen dhe Vitin e Ri të dërgon ty si dhe lexuesve të revistës "Drita" nga bashkëpunëtori i rregullt

Ullmar Qvick

Revistë kulturore - informative Shoqata Besa, në Trelleborg-Suedi
Kultur-och informationstidskrift Föreningen Besa i Trelleborg-Sverige

DRITA

Viti II
NR. 10/97
Çmimi
30:-



SABRI NOVOSELLA
VETERAN I LËVIZJES SONË KOMBËTARE